

# Shpenzimet: Edicioni i dytë i Forumit WPS

Kategoria e shpenzimeve	Totali (EUR)
<b>Akomodim</b>	
Akomodimi për 163 mysafirë ndërkombëtar pjesëmarrës në Forumin WPS për periudhën 14-17 prill 2024	<b>28.848,6</b>
<i>*Të akomoduar në hotelet: Emerald, Swiss Diamond, Sheraton dhe Venus. Po ashtu, një numër i mysafirëve ndërkombëtar nuk kanë kërkuar akomodim.</i>	
<b>Biletat e aeroplanit</b>	
Biletat e aeroplanit për 83 mysafirë ndërkombëtar pjesëmarrës në Forumin WPS	<b>126.905,87</b>
<i>*Shënim: Gjithsej 170 mysafirët e Forumit ishin nga mbi 40 shtete të botës, nga të cilët një pjesë e mysafirëve kanë udhëtuar nga rajoni me mjete vetanake, si dhe një pjesë tjetër u janë mbuluar shpenzimet nga shtetet/organizatat pjesëmarrëse, ndërsa shpenzimet e qëndrimit (pjet, drekat dhe darkat) janë mbuluar nga ZPRK.</i>	
<b>Dreka dhe darka zyrtare dhe shpenzime të tjera</b>	
Drekë – Dita 1 (900 shujta); Kanape sandviç – Dita 2 (600 persona); Mëngjes pune – Dita 1 (30 persona); Mëngjes pune me deputetë – Dita 2 (30 persona); Drekë pune e shtuar nga Presidentja – Dita 1 (36 persona); Pauzat e kafes për dy ditët e forumit (2400 persona); Darka zyrtare - Nata 2 (311 persona); 4 salla të hotelit të rezervuara për datat 14-17 prill; dekor për 4 sallat; si dhe darka gala në Grand Events (364 persona)	<b>80.643,3</b>
<b>Shpenzimet tjera</b>	
<b>Ushqimi për stafin organizativ dhe mbështetës</b>	
Përfshirë: Administrata e Presidencës; anëtarët e kabinetit; zyrtarët e angazhuar nga institucionet tjera; zyrtarët policor; ushtarët e FSK-së; stafi i kompanive të kontraktuara (si përkthimi, zërimi, regjia, etj.); vozitësit; mbrojtja e afërt dhe zyrtarët e sigurisë, etj., të angazhuar jashtë zyrës (pra tek vendi i ngjarjes dhe aeroporti) në datat 13 - 16 prill 2024 (përfshirë fazën përgatitore për Forumin).	<b>9.338,5</b>
Dita 1 (13 prill): 130 (shujta – ushqim dhe pije në vlerën deri në 8 euro)	
Dita 2 (14 prill): 240 (shujta – ushqim dhe pije në vlerën deri në 8 euro)	
Dita 3 (15 prill): 380 (shujta – ushqim dhe pije në vlerën deri në 8 euro)	

Dita 4 (16 prill); 380 (shujta – ushqim dhe pije në vlerën deri në 8 euro)

Këtu përfshihen shpenzimet për zyrtarët që janë angazhuar nga orët e hershme të mëngjesit deri në orët e vona, të cilët janë ushqyer edhe me 3 shujta.

#### **Veturat me qira**

---

15 vetura të marra me qira për bartjen e të ftuarve nga Aeroporti në vendet e akomodimit dhe anasjelltas, si dhe për transport nga hotelet e ndryshme në hapësirën ku është mbajtur Forumi, por edhe për transport në hapësirat tjera zyrtare ku kanë ndodhur ngjarje të ndërlidhura me Forumin (Darka Gala dhe eventit inaugurues të Memoriali Heroinat) **6,136.00**

#### **Kontrata për branding dhe PR**

---

Kosto totale e shërbimeve të ofruara nga kompania përgjegjëse për branding të PR të Forumit, por edhe për pjesën organizative/logjistike\* **133,517.00**

*\*Në faqen në vijim është e paraqitur lista e plotë e të gjitha shërbimeve të ofruara.*

---

**Totali i të gjitha shpenzimeve 385,389.27 euro**

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve të konfirmuar përmes regjistrimit në platformë online: 1,215  
Numri total i personave të regjistruar në pikën e regjistrimit në Forum (manual): 1,122

## **\*Lista e plotë e shërbimeve të ofruara nga Kompania e Brandingut dhe PR**

- Konceptimin dhe realizimin e ribrendimit dhe dizajnit të gjitha produkteve (fizike dhe digjitale) të edicionit të dytë të Forumit duke u bazuar në brendimin ekzistues, i cili përshtatet me temat kryesore të Forumit,
- Koncepti kreativ, duke përfshirë dizajnimin dhe realizimin e të gjitha ambienteve ku do të zhvillohet Forumi
  - a. Salla kryesore (1) - (skena, sigurimi dhe renditja e ulëseve dhe tavolinave për panelistë, skema e uljes për pjesëmarrësit, renditja e kabinave të përkthimit, skema për vendosjen e mediave, skema për vendosjen e regjisë, hapësira për rrjetëzim, dekori dhe hapësira të tjera kreative sipas propozimit); propozimi fillestar në 3D; b. Sallat e tjera ku do të organizohen panelet paralele (3) – (skena, sigurimi dhe renditja e ulëseve dhe tavolinave për panelistë, skema e uljes për pjesëmarrësit, renditja e kabinave të përkthimit, skema për vendosjen e mediave, skema për vendosjen e regjisë, hapësira për rrjetëzim, dekori dhe hapësira të tjera kreative sipas propozimit); c. Këndi i regjistrimit (1); d. Këndi i informacionit (1); e. Këndi mediatik (1); f. Këndi i OJQ-ve (1) (hapësirë promovuese ‘pitching session’); g. Konferenca paralajmëruese për media (1); h. Gala darka (1); a. Ambientet tjera të Forumit, përfshirë hapësirat lidhëse në mes të sallave, si dhe hapësirat e jashtme në hyrje të objektit ku mbahet Forumi,
- Përgatitja dhe ekzekutimi i plan veprimit gjithëpërfshirës për PR dhe komunikim, i cili përfshinë në vete një plan të zbatimit me kohëzgjatje të caktuar për secilin aktivitet që pasqyron objektivat dhe synimet e Forumit,
- Përgatitja e video materialeve promovuese në përputhje me ribrendimin e aprovuar,
- Dizajnimi i grafikave për ekranet LED,
- Vendosja e ekraneve LED në hapësira të brendshme,
- Realizimi i ndriçimit dhe efekteve vizuale në hapësirat ku do të mbahet Forumi,
- Dizajnimi, printimi dhe vendosja e materialeve tjera në hapësirat e brendshme, hapësirat lidhëse në mes të sesioneve dhe hapësirat e jashtme të Forumit, përfshirë banerat e veçantë dhe roll banerat me mekanizëm mbajtës të metalit,
- Sigurimi i të gjitha pajisjeve të zërimit dhe të audios (mikrofona mobil dhe wireless) deri në 700 persona në hapësira të mbyllura (salla),
- Organizimi dhe ofrimi i shërbimeve të përkthimit simultan me teknologjinë më të re (anglisht, shqip, serbisht dhe gjuhë të tjera sipas nevojës për të gjitha sallat ku zhvillohet forumi duke përfshirë pajisjet e zërimit, përkthimit, kabinat, kufjet) deri në 700 persona në hapësira të mbyllura (salla),
- Krijimi i sistemit elektronik të regjistrimit (zhvillimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i procesit të regjistrimit të pjesëmarrësve deri tek qasja e pjesëmarrësve në Forum),
- Regjia dhe transmetimi i të gjitha sesioneve të Forumit,
- Platforma online për mundësim të pjesëmarrjes virtuale të folësve në Forum,
- Sigurimi që një ekip multimedial (videografë, fotografë, moderatorë) të cilët do të punojnë ngushtë me Ekipin Organizativ para, gjatë dhe pas WPS-së, në dakordësi me planin gjithëpërfshirës për PR dhe komunikim,
- Ribrendimi dhe përditësimi i faqes së internetit të dedikuar për Forumin,
- Dizajnimi dhe printimi realizimi i materialeve për Forum,
- Dhurata autentike të Forumit për pjesëmarrësit,
- Raportit final i Forumit i dizajnuar.